



Pranimi / Dorezimi Priljepljen / Prodato Received / Delivery	09.11.2022	2	viti god year
Organ / Njesta Organ / Jedinstvo Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMBHIC	6921/2022		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.793/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca - kryetar, Malsore Gashi - Bajraktari, dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.793/2022 të datës 12.09.2022, të parashtruar nga ankuesja me adrese Komuna e Prizrenit, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.11.2022, mori këtë.

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.793/2022 e datës 12.09.2022, e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi, Vendimi me numër 3163, i datës 16.08.2022, i Komisionit për Grada dhe Disipline, si dhe Vendimi me numër protokoll 3167 i datës 17.08.2022, i Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Arsyetim

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 12.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 5314/2022 e regjistruar nën shenjën A.nr.793/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoll 3163 të datës 16.08.2022 të Komisionit për Grada dhe Disipline, si dhe Vendimit me numër protokoll 3167 të datës 17.08.2022 të Ministres së Ministrisë së

Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me pretendimet ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tutje referuar si Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa me datë 20.09.2022, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin me shifër VK.nr.131/2022 përmes të cilit ankesës së ankueses \nr.793/2022 të datës 12.09.2022 i ka shtyrë afatin vendimmarrës edhe për dhjetë (10) ditë punë, me qëllim të shqyrtimeve shtesë të lëndës për shkak të specifikave të saj.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5314/2022 e regjistruar nën shenjën A.nr.793/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shkresën e datës 28.07.2022; Dokumenti për i datës 11.03.2022; E-maili i datës 18.03.2022; E-maili i datës 25.30.2022; Letër certifikatash e datës 01.04.2022; Raporti njoftues për dokumentin e falsifikuar (fletudhëtim, i lëshuar nga ARKS Romë, me datë 11.03.2022); E-mail i datës 01.04.2022; E-mail i datës 04.04.2022; E-mail i datës 16.07.2022; Komunikimin me mes të dhe ankueses; E-maili i datës 04.07.2022; Dokumenti i lëshuar për E-maili i datës 28.07.2022; E-maili i datës 24.07.2022; E-maili i datës 17.07.2022; E-maili i datës 16.06.2022; E-maili i datës 17.07.2022; E-maili i datës 17.07.2022; E-maili i datës 16.07.2022; Plani vjetor për pushim për vitin 2022; Kërkesën për pushim të datës 27.06.2022; E-mailin e datës 03.07.2022; E-mailin e datës 20.07.2022; Kërkesën për pushim vjetor të datës 02.06.2022; Kërkesë për pushim vjetor të datës 25.07.2022; Kërkesën për pushim vjetor të datës 01.08.2022; Kërkesë për pushim vjetor të datës 16.08.2022; Kërkesë për pushim vjetor i datës 22.08.2022; E-maili i datës 15.07.2022; E-maili i datës 17.07.2022; Kërkesë për pushim vjetor i datës 28.06.2022; E-maili i datës 27.07.2022; Pushimi veror i vitit 2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për shërbimin e jashtëm për vitin 2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për shërbimin e jashtëm për vitin 2020; E-mailin e datës 12.08.2021; E-mailin e datës 07.11.2021; Komunikimi i datës 07.11.2021; E-mailin e datës 07.11.2021; E-mailin e datës 18.12.2021; Raportin e shkurt lidhur me ndalimin e shtetaseve Kosovar i datës 18.12.2021; Komunikimi i datës 17.12.2021; Dokumentet e udhëtimit për E-maili i datës 27.05.2022; E-mailin e datës 26.07.2022; E-mailin e datës 26.05.2022; Komunikimi i datës 07.06.2022; E-mailin e datës 09.07.2022; E-maili i datës 08.06.2022; E-maili i datës 17.07.2022; Komunikimi i datës 17.07.2022; E-maili i datës 15.07.2022; E-maili i datës 16.09.2020; E-mailin e datës 15.09.2020; E-mailin e datës 07.10.2020; E-mailin e datës 15.10.2020; E-maili i datës 03.07.2021; E-maili e datës 28.04.2021; E-maili i datës 08.07.2021; E-maili i datës 22.02.2022; Komunikim i datës 15.03.2022; e-maili i datës 18.11.2021; E-maili i datës 26.07.2020; Raportin e shqetësimeve në lidhje me keq menaxhimin dhe Mjedisin e vështir të punës në Ambasadë i datës 23.06.2020; E-mailin e datës 29.07.2020; E-maili i datës 31.07.2020; E-mailin e datës 18.02.2020; E-maili e datës 27.02.2020; E-maili i datës 09.03.2020; E-maili i datës 11.03.2020; E-maili i datës 13.03.2020; E-

maili i datës 17.03.2020; E-maili i datës 18.03.2020; Shkresën njoftuese të datës 11.07.2019, lidhur me regjistrimin e pasurisë; E-maili i datës 03.07.2019; E-maili i datës 20.12.2019; E-maili i datës 23.12.2019; Komunikimi i datës 23.12.2019; E-maili i datës 17.07.2019; Komunikimi i datës 11.07.2022; E-maili i datës 05.08.2022; Vendimi i datës 16.08.2022 i Komisionit për Grada dhe Disipline; Vendimin i datës 17.08.2022 i Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore e datës 08.7.2022; Procesverbali i datës 22.07.2022, i Komisionit për Grada dhe Disiplinë; Procesverbali i datës 01.08.2022, i Komisionit për Grada dhe Disiplinë; e-maili i datës 28.07.2022; Kërkesë e datës 28.06.2021 për pushim Vjetor; Përgjigjen në ankesë e datës 20.09.2022 me numër protokoll:5527/2022 me shkresat e bashkangjitura; Vendimin për sistemimin e ankueses i datës 01.09.2022 me numër prot:3441.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pa bazuar sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosje e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se ankueses me Vendimin me numër reference 633 të datës 23.07.2018 (*numri i protokollit dhe data e vendimit vështirë të lexueshme*) i është dhënë grada diplomatike *Sekretare e Dytë* dhe e njëjta është caktuar të shërbejë në mision diplomatik, gjegjësisht në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Itali-Romë.

Ambasadorja e Republikës së Kosovës në Itali - Romë, me datë 08.07.2022 i është drejtuar Komisionit për Grada dhe Disiplinë, me kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses, me arsyetimin se e njëjta ka kryer shkelje të rënda disiplinore.

Komisioni për Grada dhe Disiplinë pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, pas zhvillimit të procedurës disiplinore ndaj ankueses, me datë 16.08.2022 ka nxjerr Vendimin me numër protokoll 3163 përmes të cilit akt i propozon Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që ankueses *t'i shqiptohet masa disiplinore zvogëlim në gradë, nga grada Sekretare e Dytë, në gradën Sekretare e Tretë.*

Bazuar në konstatimin dhe rrjedhimisht propozimin e Komisionit për Grada dhe Disiplinë, Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 17.08.2022 përmes Vendimit me numër protokoll 3167, ankueses i shqipton masën disiplinore *zvogëlim në gradë, nga grada Sekretare e Dytë, në gradën Sekretare e Tretë*, me arsyetimin se ankuesja është gjetur përgjegjëse për shkeljet e rënda disiplinore e përcaktuara si në nenin 10 paragrafi 2, nën paragrafi 2.1.2 të Rregullores Nr.04/2014 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Shërbimin e Jashtëm.

Ankuesja, kundër Vendimit me numër 3163 të datës 16.08.2022 të Komisionit për Grada dhe Disipline, si dhe Vendimit me numër protokoll 3167 të datës 17.08.2022 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 12.09.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë, me pretendimet ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave materiale.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, në kuptim të shkeljes së ligjit material, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 4 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë; 2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për çështje specifike siç është çështja e gradimit, janë të aplikueshëm rregullat e veçanta, në këtë rast Ligji Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm i Republikës së Kosovës, dhe Rregullorja Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm, andaj meqenëse nga administrimi i provave është gjetur se shqyrtimi i inicimit të procedurës disiplinore, propozimi, sikurse edhe shqiptimi i masës disiplinore ndaj ankueses në cilësinë e nëpunësit të shërbimit të jashtëm dhe për çështje specifike siç është çështja e gradimit, është bërë në mbështetje të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet ankimore të ankueses për shkelje të ligjit material janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara.*

Rrjedhimisht, në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 30 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, ku përcaktohet se: *Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës ka për detyrë: 1.3. shqyrtimin e rasteve të shkeljeve të rënda të kryera nga nëpunësit e shërbimit të jashtëm dhe propozimin të Ministri i Punëve të Jashtme i masave disiplinore për nëpunësit që kanë kryer këto shkelje, nenit 15 paragrafi 3 nën paragrafit 3.2 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm, ku përcaktohet se: Rastet e dëshmuara ose të dyshuara të shkeljeve të disiplinës mund të raportohen te Komisioni nga: Ambasadorët/Të ngarkuarit me punë/Shefat e misionit që shërbejnë në misione jashtë vendit, si dhe nenit 15 paragrafi 7 të kësaj rregulloreje ku përcaktohet se: "Denoncimi dhe raporti për shkelje të disiplinës hetohet dhe rezultatet duhet të raportohen në Ministri brenda një (1) muaji nga dita e raportit fillestar", dhe duke marr parasysh faktin se inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankueses është bërë nga udhëheqësja e drejtpërdrejtë, gjegjësisht Ambasadorja e Republikës së Kosovës në Itali - Romë, ndërsa shqyrtimi i kërkesës për inicimin e procedurës disiplinore dhe rrjedhimisht propozimi i masës disiplinore është bërë nga Komisioni për Grada dhe Disiplinë, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor i ankueses për shkelje procedurale me rastin e inicimit dhe zhvillimit të procedurës disiplinore janë të pa bazuara, ngase procedura është zhvilluar në pajtueshmëri me dispozitat e lartcekura ligjore.*

Kolegji i Këshillit, po ashtu nga analizimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Vendimi me numër protokoll 3163 i datës 16.08.2022 i Komisionit për Grada dhe Disiplinë, përmes të cilit vendim është propozuar që ankueses t'i shqiptohet masa disiplinore, si dhe Vendimi me numër protokoll 3167 i datës 17.08.2022 i Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përmes të cilit akt ankueses i është shqiptuar masa disiplinore, zvogëlim në gradë, janë në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr.04/2014 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Shërbimin e Jashtëm, përkatësisht nenin 10 paragraf 3 nën paragrafi 3.2.3, Rregullores Nr.04/2014 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Shërbimin e Jashtëm

ku përcaktohet se: 3.2 *Për shkelje të rënda shqiptohen: 3.2.3. Zvogëlimi në gradë*” pasi që është konstatuar se ankuesja ka kryer shkelje të rëndë të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 10 paragrafi 2.1.2 të Rregullores Nr.04/2014 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Shërbimin e Jashtëm, ngase siç është konstatuar edhe nga procesverbali i seancës të Komisionit për Grada dhe Disiplinë të mbajtur me datë 22.07.2022 si dhe asaj me datë 01.08.2022, e njëjta nuk ka mundur të argumentojë të kundërtën e iniciuesit të procedurës, pasi që e njëjta me rastin e komunikimeve të rëndësishme për çështje konsullore (*rasti i mos kthimit të targave diplomatike të një personi për 7 vite*) nuk është përfshirë në komunikime edhe Shefja e Misionit/Ambasadorja, mos respektimi i protokollit dhe hierarkisë ndaj eprores/ambasadores, shprehja e përsëritur në seancën e Komisionit për Grada dhe Disiplinë se e njëjta nuk ka respekt për ambasadorin, shpërfillja dhe mos respektimi i udhëzimeve të marra nga ambasadorja me qëllim të kryerjes së detyrave, për porosinë e dërguar me rëndësi të lartë, ambasadorja nuk është kopjuar (cc) apo nuk është vënë në dijeni, ndarja e informacioneve mbi çështje të punës pa autorizim, shpërfillje të udhëzimeve, tejkallim të kompetencave, shkelje të vazhdueshme ndaj hierarkisë që përcakton funksionin e secilit në mision, injorimi i detyrave të marra nga eprori, komunikim jashtë ambasadës pa përfshirje të shefes së misionit, zvarritje e detyrave të deleguara, mos raportimi i detyrave të punës, mosbindje kundrejt detyrave dhe mos përgjegjësi që i takon funksionit, largimi nga vendi i punës pa lejen e shefit të misionit.

Andaj, në bazë të konstatimeve të dhëna si më lartë si dhe duke u bazuar në nenin 25 paragrafi 1 dhe 3 si dhe nenin 26 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/ -114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se; 1. *Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut.* 3. *Zyrtari publik duhet të veprjë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike; neni 6, 1. Zyrtari publik ka detyrimin të veprjë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit”,* rrjedh se për shkak të mos respektimit të detyrave të punës si dhe mos respektimit të obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e ligjit të aplikuar ankuesja është përgjegjëse për veprimet e saja.

Kolegji i Këshillit, meqenëse nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesja pas përfundimit të misionit të rregullt katër (4) vjeçar përmes Vendimit të datës 01.09.2022 është sistemuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në pozitën *“Zyrtare e Lartë për Organizata Ndërkombëtare”*, vlerëson se është respektuar parimi i përgjithshëm i sigurisë juridike.

Për sa me sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se organi i punësimit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokoll 3163 të datës 16.08.2022 si dhe Vendimit me numër protokoll 3167 të datës 17.08.2022 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.793/2022

Rushit KAITAZI

Procesmbajtës

Jeton KOÇA

Kryetari i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në MPJD;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MPJD; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.